



ZYRA E VETËORGANIZIMIT STUDENTORË

PLANI STRATEGJIK 2013-2017

MISIONI DHE VIZIONI

Zyra e Klubeve Studentore ose ndryshe zyra e vetëorganizimit studentorë në SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti" është e institucionalizuar në rregulloren e institucionit. Kjo strukturë është nën varësinë e Dekanit të Studentëve dhe funksionon në mënyrë të pavarur nga ana organizative, duke u vetëorganizuar dhe duke i ardhur në ndihmë të gjithë organizmave administrativë ose akademikë për bashkëpunim në fushat specifike që klubet studentore përmbajnë.

Klubet janë të krijuara nga studentët dhe të mbështetura nga pedagogët si figura që kujdesen për funksionalitetin e klubeve. UMB i inkurajon studentët të angazhohen aktivisht në tetë klube. Klubet e UMB sigurojnë mundësi për zhvillim lidhshëm, përmbushje të dëshirave personale dhe sigurojnë mundësi për kontribut ndaj shoqërisë.

Klubet studentore bartin energjinë e studentëve të UMB. Numri i klubeve (që janë formuar dhe drejtuar nga studentët) reflekton larminë e interesave të komunitetit të studentëve. Klubet dhe organizimet studentore u ofrojnë studentëve mundësi për pjesëmarrje në veprimtaritë akademike, kulturore, sociale dhe sportive që përputhen me zhvillimin e dijeve, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve që rekomandohen nga profesionistët e fushës.

OBJEKTIVA

1. Organizon aktivitete dhe shërbime për studentët nga studentët.
2. Mbikëqyr dhe ndihmon këshillat e klubeve dhe përfaqësuesit (studentët).
3. Inicion aktivitete të shumëllojshme, të cilat janë të vetëorganizuara nga klubet studentore.
4. Vë në praktikë të gjitha projektet e propozuara nga departamentet apo nga administrata në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë Klubet dhe studentët e UMB-së.
5. Ndhmon dhe bashkëpunon në projektet të cilat kanë natyrë kulturore, turistike, gjithashtu i vjen në ndihmë për bashkëpunim Zyrës së shërbimeve studentore në përmbushjen e objektivave të saj.



6. Zhvillon veprimtari që sigurojnë dhe nxisin marrëdhëniet pozitive mes studentëve të fakulteteve, dhe kampuseve të tjera.
7. Publikon dokumente informative mbi veprimtarinë e Klubeve dhe organizimin e takimeve të shpeshta me profesionistë të fushave përkatëse.
8. Shërben si adresë e përhershme për të mbajtur lidhjet.

SHËRBIMET E ZYRËS

Në përmbushje të objektivave të saj kjo zyrë ofron shërbimet e mëposhtme:

- Leksione të hapura, prezantime, workshope, seminare, tryeza të rrumbullakta në funksion të pasurimit dhe fuqizimit të jetës studentore;
- Orientime lehtësuese duke ndihmuar në organizimet e takimeve, mbledhjeve, paraqitjes së projekteve dhe përcjelljen e çdo projekti drejt Dekanit të studentëve;
- Aktivitete të larmishme në fushën e artit, politikës, sportit, vullnetarizmit dhe informimit;
- Projekte binjakëzimi shkolla komunitare, kurse verore dhe konkursenë fusha të ndryshme;
- Evente periodike për të ushqyer njëtrajtshmërisht tek studentët pasionin për ruajtjen dhe përcjelljen e traditave.